



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:103287

Datë: 02.12.2019

Numri i dokumentit: 00736309

C.nr.986/17

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu , me procesmbajtësin Valmir Hakiu, në çështjen juridike të paditësit M.A.D nga fshati, Komuna Ferizaj, kundër të paditues Komuna Shtime, për vërtetimin e pronësisë, pas mbajtjes së seancës kryesore publike, me dt. 13.11.2019, mori ndërsa përpiloi më dt.02.12.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M.D nga fshati ..., Komuna Shtime, kundër të paditurit Komuna Shtime, me të cilin **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i NK.nr...., në vendin e quajtur “Sh...” me sipërfaqe prej 2345m2, ZK Pjetërshticë, dhe të **DETYROHET** e paditura që tia njohë të drejtën e pronësisë dhe tia lejoj që këtë të drejtë ta regjistroj në regjistrin kadastral, **si e pabazuar**.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M.D nga fshati ... , Komuna Shtime, ka ushtruar padi me dt. 02.11.2017 kundër të paditues Komuna Shtime, lidhur me çështjen juridike padi për vërtetimi i pronësisë.

Paditësi nëpërmjetë të autorizuarit të tijë Av.S.J në padi, seancë dhe fjalën përfundimtare deklaroi: paditësi M.D me vite të tëra është në posedim të palujtëshmëris – sipërfaqës prej 2345 m2 sipas gjendjes faktike pas matjes të njësis nr ... në vendin e quajtur “L... në sipërfaqe prej 6248 m2 të evdientuar në cartfikatën mbi të drejtat e pronën e palujtshme nr ... ZK Pjetërshticë , ka poseduar dokumentacionin e nevojshem pronësor porse I njejkti është zhdukur gjatë luftës në Kosovë dhe në ditën e sotme është në posedim e shfrytëzim të qetë e të pa penguar nga askush në këtë palujtëshmëri . E kemi pranuar ekspertizen e ekspertit gjeodet R.U në të njejtën kohë kemi dërzuar parashtresën për procesin e padis sepse sipas ekspertit në rastin e daljes në vendëngjarje është vërtetuar se lënda kontestit do të jetë parcela kadastrale nr ... në vendin e quajtur Sh... në kulturë mal I klasës 6 me sipërfaqe prej 2345m2 nga sipërfaqësja e pergjithëshme 12665 m2 ZK Pjetërshticë , si në theksimet e mëparshme me propozim që padia dhe kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar me ligj , se paditësi ashtu edhe parardhësit janë në posedim të qetë mbi 50 vite në këtë palujtëshmëri këtë gjendje faktike është vërtetuar më rastin e daljës ne vendëngjarje me

ekspertin gjeodet . Sipas vendimit tonë paditësi e ka fituar të drejtën e pronësis edhe me parashkrim fitues (Usu Kapio) konform nenit 40 LPDS dhe nenit 28 par 4 të LMPPJ-së , andaj I propozoj gjykatës që të marr aktgjykim me te cilin aprovohet padia e paditësit M.D dhe vërtetohet se është pronar i pronës me nr ... në vendin e quajtur Sh... me kultur mal I klasës së gjashtë me sip 2345 m2 ZK Pjetershticë.

Përfaqësuesi i të paditues, L.M, në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në fjalën përfundimtare deklaron se njësia kadastrale me nr. çartifikate UL-...-...-0 ZK. Pjetershticë, numri i njësisë P-72809064-..., me sipërfaqe prej 6248 m2, në vendin e quajtur L..., të shënuar në cartifikatën mbi të drejtat në pronë të patundëshme, e cila evidentohet si pasuri shoqorore e Kuvendit Komunal Shtime. Komuna e Shtimes në arkivin e saj nuk ka asnjë dokument që figuron se kjo parcelë është shitur ndonjëherë apo se ka pasur pronar tjetër, komuna nuk e shfrytëzon atë parcelë edhe pse figuron si pasuri e komunës dhe po ashtu nuk dihet se si është regjistruar si pasuri shoqorore sepse nuk ka asnjë dokument, historiati i kësaj parcele nuk ekziston pasi që gjatë luftës së fundit është marrë nga Serbia dhe deri më tash ende nuk është kthyer, derisa të kthehet, e paditura nuk ka asnjë të dhënë lidhur me këtë pronë për veqë asaj që figuron si pasuri shoqorore e Kuvendit Komunal Shtime, për këtë e paditura e kundërshtonë në tërsi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Dëshmitari RR.K deklaron, se jam në dijeni që M... ka një tokë në Pjetërshticë dhe me ka dërguar në atë vend për të marrë hunjë për patligjana kjo ka ndodhë para 2-3 vite, unë e di që janë afërsisht 20 ari, nuk me ka thënë që kam dokumente po vetëm i këmi prerë hunjët dhe më ka thënë që është e imja dhe askush nuk e ka penguar ndonjëherë .

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave: lexohet ekspertiza e ekspertit gjeodetit R.U , Certifikata e pronës P-0..., ZK. Pjetershticë e datës 22.10.2019 .

Gjykata pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veq e veq dhe të ndërlidhura mes veti, si tërsi dhe mbi bazën e bindjes së lire të krijuar dhe fakteve e provave të çështjes ka vlerësuar se duhej të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën nuk është kontestuese prona pasi që një gjë tillë vërtetohet nga Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë R.U, e dt. 16.10.2019, i cili konstatoj se : sipas indentifikimit në teren dhe matjeve në prezencë të palëve dhe gjykatës është vërtetuar se nuk ka të bëjë me ngastren nr. ..., me sip prej 6248m2, mirëpo kontesti gjendet në pjesën e ngastrës nr ..., e cila ka sipërfaqe të përgjithëshme 12665m2 dhe e njëjta udhëhiqet në emër të Kuvendit Komunal Shtime si pasuri shoqorore, e ku pala pretendon se i ka 2345m2, në këtë ngastër. Gjendja faktike e indentifikuar në terenë është me kulturë malë. Ngastra kadastrale e lartpërmendur është evdientuar në emër Kuvendit Komunal Shtime, si pasuri shoqorore, e gjendja e vjetër dhe e tanishme në operatin kadastral, ngastra e lartë përmendur nuk ka pasur ndryshime në regjistrat publik të ndërrimëve pasi këtë evidence e kemi trashëguar nga administrata e mëhershëm e paraluftës, zyra kadastrale komunale në Shtime, nuk ka bërë ndryshime lidhur me

ngastrën e lartëpërmendur pasi që nuk ka pasur asnjë parashtrim të kërkesë nga palët që do të ndryshonte të dhënat e pronarëve në bazë të akteve ligjore të vërtetuar pranë organëve kompetente të vendit, konstatoj se për ngastrën e lartëcekur nuk kemi në regjistrat e ndërrimeve në qoftë se ka pasur ndërrime më herët paralufte.

Për gjykatën ishte kontestues fakti për vërtetimin e pronësisë, pasuri kjo që evidentohet si pronë shoqërore.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar ngase si e tillë është e pa qëndrueshme dhe e pa mbështetur në prova përmes të cilave do ta bindte gjykatën ashtu siç është e paraparë në nenin 7.1 të LPK-së ku thuhet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, si dhe bazuar në nenin 319 par 1 dhe 2 të LPK-së, meqenëse pala paditëse nuk ka arritur që të prezantoj prova përkitazi me pretendimet e saj edhe pse barra e të provuarit ka qenë në anën e palës paditëse si inicuese e kontestit në fjalë, pasi që kjo pronë është e evidentuar në emër të Kuvendit Komunal Shtime si pasuri shoqërore, edhe nga gjendja e vjetër dhe e tanishme në operatin kadastral nuk ka shënime se ka pasur ndonjë ndërrim pronari, gjykata nisur nga një gjendje e tillë dhe në pamundësi që të vërtetoi pretendimet e palës paditëse për shkak se e njëjta nuk ka sjellë asnjë provë të vetme.

Gjykata vlerëson se pretendimet e palës paditëse nuk kanë mbështetje ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë siç kërkohet në kërkesë padi, në asnjë nga mënyrat të cilat ligji i parasheh për fitimin e të drejtave pronësore, as derivative apo origjinere pasi nga gjendja faktike paditësi nuk ka provuar pretendimet e tija.

Njëherit për gjykatën nuk është vërtetuar pronësia as me anë të parashkrimit fitues pasi që për ta fituar pronësinë me anë të kësaj forme duhet të plotësohen dy kushte dhe atë mbajtja e pronësisë me mirëbesim dhe të ligjshëm, edhe në rastet kur mirëbesimi supozohet por ligjëshmëria duhet argumentuar e në rastin konkret paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar ligjshmërinë në lidhje me pretendimet e tij siç parashihet me nenin 28 të LTHMJP-së.

Andaj mund të konkludojmë se nga provat të cilat janë administruar dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve nuk është provuar me asnjë provë që gjykata tija njohë të drejtën e pronësisë në ngastrën e përshkuar në dispozitiv të aktgjykimit e cila evidentohet si pronë shoqërore.

Gjykata provat e administruara në këtë çështje e të cilat nuk janë arsyetuar në mënyrë të veçantë, i ka konsideruar si të pa rëndësishme në vendosjen lidhur me këtë çështje.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi bazuar në nenin 450 të LPK-së, që secila palë që ti bartë shpenzimet e veta procedurale .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
C.nr.986/17 dt. 02.12.2019

Gj y q t a r i

Bekim Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur kundër këtij aktgjykimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.